



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Blerina Huruglica	24.08.2023	31.08.2023	2023/0597

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **18.08.2023**, OE “S.I.G. SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: **2023/0597**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Internal Security Association” SHPK, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Sigurimi fizik i objekteve të KEK-ut” me nr. të prokurimit: “KEK-23-4552-2-1-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **2,780,159.38€**.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankesës.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat ligjore që supozohet se Autoriteti Kontraktues i ka shkelur:

Neni 1 - Qëllimi,

Neni 7 - Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi,

Neni 10 - Mjetet për promovimin e Transparencës,

Neni 28 - Specifikimet teknike,

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve,

Neni 60 - Kriteret për dhënie të kontratës,

Neni 61 - Tenderet Jo-normalisht i Ulët,

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale,

Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Si palë e interesit konform par.1.26 të Nenit 4 të LPP-së, të pa kënaqur me njoftimin mbi vendimin e AK-së "**Korporata Energjetike e Kosovës**" të datës 02.08.2023 dhe vendimin (përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim) të datës 09.08.2023 në lidhje me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi fizik i objekteve të KEK-ut" me nr. prokurimi: KEK-23-2552-2-1-1 në afatin e lejuar ligjor konform Nenit 109 të Ligjit për Prokurimin Publik, ushtrojmë këtë "Ankesë" pranë OSHP-së:

Për shkak se AK: "Korporata Energjetike e Kosovës"

- Në mënyrë të kundërligjshme ka rekomanduar për kontratë për aktivitetin e prokurimit me të dhënat e lartëcekura një OE i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e AK-së të vendosura në Njoftimin për kontratë dhe Dosjen e tenderit dhe

- Në mënyrë të padrejtë e ka eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, kompaninë tonë e cila ka plotësuar të gjitha kërkesat e vendosura në Njoftimin për kontratë dhe Dosjen e tenderit.

Pas pranimit të vendimit të Autoritetit Kontraktues, kemi kërkuar qasje në dokumentacionin e gjithë aktivitetit të prokurimit konform par.3 të Nenit 10 të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues **nuk na ka lejuar qasje të plotë** në të gjithë dokumentacionin e aktivitetit të prokurimit, por ka ofruar vetëm qasje të kufizuara duke na treguar në kompjuter vetëm disa pjesë të OE të rekomanduar për kontratë, duke na mohuar të drejtën e qasjes konform dispozitës së **Nenit 10 të LPP-së**, të njejtit nuk na kanë ofruar që dokumentet të i pranojmë përmes USB, pasi që janë thirrur në konfidencialitet/sekret afarist, mirëpo **Neni 11 i LPP-së përkatësisht par.4** i LPP-së e rregullon këtë çështje ku thuhet se AK një element brenda dokumentit të klasifikuar si sekret afarist duhet të përgatis versionin e "**pastruar**", gjë që nuk është bërë nga Autoriteti Kontraktues.

Andaj ne jemi krejtësisht të diskriminuar dhe nuk jemi trajtuar në mënyrë të barabartë konform **Nenit 7 të LPP-së**, si për rastin e eliminimit të kompanisë sonë poashtu edhe në rastin e ofrimit të qasjes në dokumentacionin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Andaj me rastin e mos pranimit të dokumentacionit të këtij aktiviteti të prokurimit në përgjithësi dhe dokumenteve të OE të rekomanduar në veqanti **dyshojmë se i njejtë nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë**, pasi që janë disa dokumente që nuk kemi arritur ti shohim se të njejtat i njejtë i posedon, andaj mbetet obligim i ekspertit shqyrtues dhe panelit të OSHP-së të vërtetoj nëse i njejtë i plotëson dhe i posedon dokumentet e kërkuara sipas dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Sipas procesverbalit të datës 12.06.2023 të hapjes së tenderëve janë pranuar gjithsejt 7 oferta. Sipas vendimit të datës 02.08.2023 Autoriteti Kontraktues nxjerr rezultatin se nga gjithsejt 7 oferta vetëm 2 janë pranuar si të përgjegjshme, OE i rekomanduar për kontratë "Internat Security Association Shpk" dhe OE me emër tregtar "Defence Security Shpk & International Security AAH Shpk".

Autoriteti Kontraktues me rastin e vlerësimit të ofertave nuk ka rrespektuar Nenin 1 të LPP-së pasi që Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të rrespektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, autoritetet kontraktuese.

Autoriteti Kontraktues me rastin e përcaktimit të kërkesave të saja për këtë procedurë të prokurimit në vehte së pari nuk e ka rrespektuar qëllimin e aktivitetit të prokurimit pasi që ka vlerësuar në mënyrë jo të drejtë dhe ka shkelur kërkesat e vehta, duke na vu në lajthim operatorët ekonomik të tjerë të cilët i kemi zbatuar në përpikmeri të gjitha kërkesat e parashtruara.

Poashtu Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e Nenit 7 të LPP-së pasi që nuk na ka trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë pjesëmarrësit në këtë aktivitet të prokurimit sepse **Analizat financiare të asnjë operatori ekonomik nuk janë vlerësuar dhe krahasuar konform Nenit 59.4** të LPP-së sepse të gjitha kërkesat kanë qenë mjaft të kjartha dhe janë dhënë mjaftë sqarime për të përgatitur ofertuesit ofertat e tyre në bazë të kërkesave duke rrespektuar **Ligjin e Punës Nr.03/L-212**.

Në mënyrë të qartë kanë qenë të cekura dhe të specifikuara kërkesat në bazë të Nenit 28 të LPP-së specifikimet teknike të detyrueshme e për të cilat kemi qenë të obliguar ti rrespektojnë sipas udhëzimeve të dhëna nga Autoriteti Kontraktues e më pastaj të njejtat kerkesa gjatë vlerësimit krahasimit dhe ekzaminimit të ofertave konform Nenit 59.4 të LPP-së nuk janë rrespektuar, dhe në mënyrë jo të drejtë eliminohemi.

Autoriteti Kontraktues me datën 09.08.2023 nxjerr vendim duke refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim si të pabazuar **duke mos u përgjigjur** të gjitha pretendimeve tona ankimore edhe pse i njejtë është i obliguar që sipas rregullave dhe dispozitave ligjore të LPP-së dhe Rregullores Nr.001/2022 të na përgjigjet secilit pretendim ankimor, AK nuk trajton pjesën ku kemi dëshmuar "përgjegjshmërinë" e ofertës sonë, si dhe jep mendimet e vehta lidhur me eliminimin e kompanisë sonë në mënyrë të padrejtë dhe tendencioze edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Kompania jonë ashtu siq e kemi cekur edhe në kërkesën tonë për rishqyrtim të datës 06.08.2023 është eliminuar padrejtësisht në mënyrë tendencioze pasi që është e vetmja kompani se ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë sipas Aneksit 1 të vendosura në Specifikimet teknike të Detyrueshme.

Eliminimi i kompanisë sonë në arsyetim se:

Keni dëshmitë se posedoni vetëm dy vetura të dokumentuara për shfrytëzim në bazë të kërkesës në DT, ndërsa për veturat tjera mungon dokumentacioni që anëtarët e konsorciumit i

kanë në shfrytëzim.

Provë:

Letër standarde për tenderuesin e eliminuar, datë 02.08.2023

Kompania jonë e ka kundërshtuar eliminimin e kompanisë sonë në arsyetimin e cekur, pasi që ne kemi vendosur numër të mjaftueshëm të dokumenteve lidhur me veturat e kërkuara, ne poashtu kemi bashkangjitur të gjitha marrëveshjet për shfrytëzimin e tyre me qera nga kompanitë bashkëpunuese.

Provë:

Oferta e kompanisë sonë, si dhe dokumentacioni i vendosur.

Ashtu siq e kemi potencuar në kërkesën për rishqyrtim Autoriteti Kontraktues me rastin e vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit të ofertave nuk e ka bërë konform Nenit 59.4 të LPP-së, pasi që në njërin anë ofertën e OE të rekomanduar për kontratë e krahason si të përgjegjshme, në anën tjetër ofertën tonë e eliminon pa asnjë bazë ligjore në mënyrë tendencioze.

Konzorciumi ynë "SIG Shpk & Group for Security Shpk" në ofertë ka të vendosur gjithsejt 10 vetura, kurse kërkesa e Autoritetit Kontraktues ka qenë të vendosen 4 vetura patrolluese.

- Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet "SIG Shpk" dhe "Jaguar Security Shpk" i datës 09.06.2023 saktësisht në Nenin 3 specifikohet kjartazi se "Dokumentet e veturave të kompanisë Jaguar Security Shpk të cilat i ka në emër të saj apo kompanive të tjera me të cilat ka marrëveshje Rent a Car Mara dhe Elron Shpk, për të cilat kompania Jaguar Security Shpk ka marrëveshje të lidhura me këto kompani për marrjen e veturave me qera gjithashtu i lejohet se të njejtat vetura të këtyre dy kompanive të lartëcekura do të mund ti përdor për këtë tender, gjë që i lejohet dhe i jepet kjo e drejtë nga ana e kompanisë Jaguar Security Shpk".

Provë:

Marrëveshjet e bashkangjitura në ofertë.

Andaj Autoriteti Kontraktues pa të drejtë po e ri-potencojmë se na ka eliminuar padrejtësisht në këtë aktivitet të prokurimit.

Me rastin e eliminimit të ofertës sonë në arsyetim se nuk kemi plotësuar kërkesën e Autoritetit Kontraktues dhe nuk kemi ofruar dëshmi në përmbushjen e kërkesës për 4 vetura, dhe se marrëveshja e ofruar nga ana jonë për shfrytëzimin e veturave nuk është cilësuar si valide. Ky arsyetim nuk është ligjor pasi që marrëveshjet e dorëzuara tërësisht janë ligjore dhe valide dhe nuk mund të konsiderohen ashtu siq i ka konsideruar Autoriteti Kontraktues si jo valide për shkak se në asnjë dispozite të atyre marrëveshjeve nuk e specifikon se ndalohet dhënja e automjeteve në shfrytëzim të ndonjë palë e tretë, poashtu në rastin në fjalë Autoriteti Kontraktues për të hequr dilemat që ju kanë shfaqur gjatë vlerësimit ka mundur që në bazë të Nenit 72 të LPP-së të kërkoj sqarime shtesë lidhur me marrëveshjet dhe jo në mënyrë të padrejtë të na eliminoj për diçka të till.

Kompania jonë poashtu gjatë hartimit të ofertës (cmimit) është bazuar në të gjitha elementet e

cekura në njoftimin për kontratë, dosje të tenderit dhe Aneksin 1 tek specifikimet teknike të detyrueshme ku ka kërkuar që Ligji i Punës Nr.03/L-212 të rrespektohet në tërësi e që kjo nënkupton se të gjithë ofertuesit kanë qenë të obliguar që gjatë hartimit të cmimit të rrespektojnë dispozitat ligjore të këtij Ligji e në veqanti Nenin 56 të Ligjit të Punës ku parashihet pagesa shtesë si dhe Neni 32 i Ligjit të Punës (pushimi vjetor), e që asnjë operator ekonomik i cekur si më poshtë nuk ka rrespektuar këto kërkesa me crast i bie se Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit të ofertave nuk ka vepruar konform Nenit 59.4 të LPP-së dhe nuk ka rrespektuar kërkesat e veta të cekura, e që i bie se ne si operator ekonomik jemi vu në lajthitje.

Operatorët ekonomik si më poshtë pos që janë eliminuar nga ana e Autoritetit Kontraktues për shkak të mungesës së dokumentacionit të njejtit nuk janë të përgjegjshëm financiarisht për shkak se nuk kanë vepruar konform kërkesave për rrespektimin e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, andaj edhe nuk mund të konsiderohen si palë me interes konform Nenit 4 par.1.26 të LPP-së.

1. OE - Bold Security Shpk & Drita Security Shpk (cmimi i ofertuar nuk mbulon kërkesat e dosjes së tenderit, nuk ka rrespektuar pagesat shtesë dhe pushimin vjetor sipas Ligjit të Punës Nr.03/L-212).

2. OE - SAS Shpk (cmimi i ofertuar nuk mbulon kërkesat e dosjes së tenderit, nuk ka rrespektuar pagesat shtesë dhe pushimin vjetor sipas Ligjit të Punës Nr.03/L-212).

3. OE - Internat Security Association Shpk (cmimi i ofertuar nuk mbulon kërkesat e dosjes së tenderit, nuk ka rrespektuar pagesat shtesë dhe pushimin vjetor sipas Ligjit të Punës Nr.03/L-212, i njejt poashtu ka mungesë të dokumentacionit dhe është dashur të eliminohet e jo të rekomandohet).

4. OE - Defence Security Shpk & International Security AAH Shpk (cmimi i ofertuar nuk mbulon kërkesat e dosjes së tenderit, nuk ka rrespektuar pagesat shtesë dhe pushimin vjetor sipas Ligjit të Punës Nr.03/L-212, i njejt poashtu ka mungesë të dokumentacionit dhe është dashur të eliminohet e jo të rekomandohet).

5. OE - Rojet e Nderit Shpk (cmimi i ofertuar nuk mbulon kërkesat e dosjes së tenderit, nuk ka rrespektuar pagesat shtesë dhe pushimin vjetor sipas Ligjit të Punës Nr.03/L-212).

Kurse sa i përket OE - Security Code Shpk i njejt ka rezultuar edhe si më i shtrenjt dhe është eliminuar në mungesë të listës së kontratave dhe referencave, andaj nuk mund të cilësohet edhe i njejt si palë e interesit.

OE i rekomanduar për kontratë "Internat Security Association Shpk" pretendojmë **se nuk është i përgjegjshëm** qoftë administrativisht (në dokumentacion) poashtu edhe financiarisht (sipas analizës financiare).

Në kërkesë për rishqyrtim e kemi cekur se i njejt **Analizën financiare të prezantuar e ka të gabuar dhe jo të plotë** konform asaj se çfarë është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit/ Aneksin 1 tek specifikimet teknike të detyrueshme.

Gjatë qasjes së kufizuar në dokumentet e po këtij operatori ekonomik kemi hasur se i njejt nuk e përmbush kërkesën nr.2 pika b), ku zyrtari i ngarkuar për shëndet dhe siguri në punë **nuk e ka vendimin valid të ri-certifikimit** të MPMS-së. Ne e kemi atakuar këtë pikë gjatë kërkesës

për rishqyrtim, kurse Autoriteti Kontraktues ka dhënë një shpjegim formal dhe jo të bazuar konform dokumentacionit të duhur.

Provë:

Certifikata e ofruar nga ana e OE për personin Shaban Hereqi i cili nuk është i ricertifikuar me vendim nga ana e MPMS.

Poashtu dyshojmë se dëshmitë e tjera si: dokumentet e 4 menaxherëve të zonave nuk i përmbush ky Operator Ekonomik i rekomanduar për kontratë, pasi që nuk na është lejuar shiqimi i dokumenteve të këtyre personave që ka angazhuar.

I njejtë dyshohet se nuk ka plotësuar kërkesat e tjera konform Nenit 69 të LPP-së, andaj kërkohet që të vërtetohet se i njejtë ka të vendosura dokumentet e kërkuara sipas pikës 1,2,3,4 të Nenit 69 të LPP-së.

Kërkesat e Autoritetit Kontraktues në dosjen e tenderit përkatësisht tek Aneks 1 - Specifikimet teknike të detyrueshme:

4. Duke marr parasysh rëndësinë e objekteve që duhet të ruhen si dhe nivelin stafit dhe motivimit të tyre çështja e pagave të rojeve fizike është e një rëndësie të veçante për autoritetin kontraktues. Paga minimale bruto bazë (te pagesave shtese dhe lejimeve konform Ligjit të Punës ne fuqi), për roje fizike të angazhuar ne këtë kontratë duhet të jetë jo me pak se 386 € ne muaj. Ky çmim është për ndërrimin e pare. Kontraktori është i obliguar që të respektoj Ligjin e punës dhe Udhëzimin Administrativ të MPMS Nr. 09/2017 . Ne këtë rast Kontraktori obligohet të paguaj shtese mbi pagën baze për ndërrimin e dyte dhe te trete dhe festa. Kontraktori obligohet të furnizojë edhe një shujtë të ngrohte për çdo ndërrim. Duke iu referuar Ligjit të punës ne fuqi dhe UA të ndërlidhura, fondi orëve për një muaj është 176 për një muaj.

5. OE obligohet të angazhojë edhe një Projekt menaxher dhe 4 mbikëqyrës të zonave. Projekt menaxheri si dhe te 4 mbikëqyrës (menaxherë) të zonave të kërkuar sipas DT kane obligim të jene të angazhuar dhe të janë prezent ne zonën e sigurisë se KEK-ut dhe zonat e veta si vend pune të vetëm (se paku 8 ore ne dite gjate pese (5) ditëve të javës) dhe kane përgjegjësi të plote për zonën e vet. Paga minimale për një menaxher duhet të jete minimum 500 € /muaj.

Andaj **manipulimi** i bërë nga ana e OE të rekomanduar për kontratë tek ANALIZA FINANCIARE e që nuk ka përfshirë të gjitha elementet e kërkuara ka rezultuar në mos trajtim të barabartë dhe në mënyrë diskriminuese vepron gjatë vlerësimit, e që komisioni nuk e ka pasur në konsideratë Nenin 59.4 të LPP-së.

Neni 38.5 i Rregullores Nr.001/2022 dhe Neni 72.1 tregojnë qartazi se: Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

Poashtu Autoriteti Kontraktues është në dijeni se në bazë të Nenit 69.8 të LPP-së ne si Operator ekonomik kemi të drejtën e mbështetjes në kapacitetet subjekteve të tjera: "Një

operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me ta. Ai në këtë rast duhet të dëshmojë për autoritetin kontraktues që ajo do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, për shembull, duke prodhuar një ndërmarrje nga ato entitete në vend burimet e nevojshme në dispozicion të operatorit ekonomik. Nën të njëjtat kushte një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështetet në aftësitë e pjesëmarrësve në grup ose në subjekte të tjera.”

Përfundimisht eliminimi i kompanisë sonë është në kundërshtim edhe me Nenin 40.12 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik.

Autoriteti Kontraktues vlerësimin e ofertave përfundimisht nuk e ka kryer në bazë të Nenit 59.4 të LPP-së dhe Nenit 60 pasi që kriteri kryesor ka qenë oferta e përgjegjshme me çmimin më të ulët e që në këtë rast ofertuesi i rekomanduar për kontratë nuk ka bërë Analizë financiare sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues kështu që duke manipuluar me shifrat dhe vlerat në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit të Punës Nr.03/L-212.

Më poshte ju kemi demonstruar kalkulimet jo reale dhe jo të sakta të operatorit ekonomik “International Security Association” dhe “Defence Security”, pasi që asnjeri nuk i plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues të specifikuara në dosjen e tenderit, e që këto kërkesa na janë obliguar para dorëzimit të ofertave tona në platformen e prokurimit.

Andaj edhe ju me rastin e rekomandimit të këtij operatori ekonomik keni rënë në kundërshtim edhe me Nenin 17.31 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin publik pasi që kjo dispozitë thotë se “Ofertat nga ofertuesit të cilët nuk kanë marrë parasysh obligimet e dispozitave të mbrojtjes së punëtorëve dhe kushteve të punës të identifikuar nga autoriteti kontraktues në dokumentet e kontratës nuk mund të konsiderohen si në përputhje me dokumentet e kontratës. Për më tepër, kur ofertuesit nuk marrin parasysh në mënyre të mjaftueshme këto detyrime në tenderët e tyre, tenderët e tyre mund të konsiderohen si jo-normalisht të ulët dhe mund të refuzohen për këtë arsye.”

ANALIZAT FINANCIARE:

INTERNAT SECURITY ASSOCIATION SH.P.K.

Në vijim e keni analizen financiare:

Totali me pushim	415.53
Kontributi	20.78
Totali me kontribut	436.31
Oret e natës	0.00
Festa	0.00
Shujta	34.47
Sigurimi shëndetsor	8.00
Uniforma	5.00

Totali i pagës	483.78
123.67 ndërrimi i parë	9,828.64
Totali mujor	186,816.51
Totali për 12 muaj	2,241,798.12
Menaxherat 600*5	3000.00
Total 12 muaj	36000.00
Totali i përgjithshëm	2,277,798.12
Tvsh	410,003.66
Totali me tvsh	2,687,801.78
Cmimi jonë i ofruar	2,720,579.90
Diferenca	32,778.12
Diferenca për 12 muaj	2,731.51

Tek ky Operator ekonomik gjatë kalkulimeve që i ka bërë shihet se nuk janë konform dispozitave ligjore të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, për shkak se llogaritja e cmimit njësi për orë pune nuk është konform Nenit 56 të po këtij ligji pasi që parashihen pagesat shtesë si: orët e punës gjatë natës, gjatë festave, gjatë kujdestarive si dhe gjatë vikendeve, për të cilat ky OE ju është shmanguar kalkulimit të saktë, me crast ka arritur të lajthit Autoritetin Kontraktues që të mos arrij që gjatë vlerësimit të bëjë llogaritje të saktë.

DEFENCE SECURITY SH.P.K.

Pagat duke perfs hire te gjitha ndrrimet jane	371 x 422.9 x 12 muaj	1,882,751.00
35 punetore shtese si zevendesues	35x386x12	162,120.00
Pagat e menaxhereve 4 I Projekt menaxheri	119.20*22*12	31,468.80
Per festa eshte parapare nje buxhet prej	12 festa	7,500.00
Shujta x 1 Euro x 365	286*2*365	208,780.00
Sigurimi shendetesor	406*7*12	34,104.00
Fitimi	101.41*12	1,216.88
Totali		
2,327,940.68		
Totali me tvsh		
2,746,970.00		

Tek ky Operator ekonomik gjatë kalkulimeve që i ka bërë shihet se nuk janë konform dispozitave ligjore të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, për shkak se llogaritja e cmimit njësi për orë pune nuk është konform Nenit 56 të po këtij ligji pasi që parashihen pagesat shtesë si: orët e punës gjatë natës, gjatë festave, gjatë kujdestarive si dhe gjatë vikendeve, për të cilat ky OE ju është shmanguar kalkulimit të saktë, me crast ka arritur të lajthit Autoritetin Kontraktues që të mos arrij që gjatë vlerësimit të bëjë llogaritje të saktë.

Neni 7 (Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi) lidhur me Neni 69 (Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale)

Autoriteti Kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka pasur në konsideratë Nenin 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi) ku Qëllimi i këtij neni është që Autoriteti Kontraktues t'i trajtoj në mënyrë të barabartë operatorët ekonomik dhe jo në mënyrë diskriminuese dhe poashtu të veprojnë në mënyrë transparente.

Konsiderojmë se AK na eliminon pa kurrfar baze dhe padrejtësisht na shkakton dëme në mënyrë që të favorizon kompaninë e rekomanduar për kontratë dhe ne si palë e dëmtuar do të vazhdojmë ankimmimet tona për shkaktimin e dëmit në këtë procedurë në instanca të tjera nëse nuk riparohet vendimi dhe vlerësimi konform Nenit 59.4 të LPP-së.

Par.4 i Nenit 59 të LPP-së thotë: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit."

Andaj bazuar në të gjitha të gjeturat dhe të cekurat më lartë konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues aktivitetin e prokurimit Vlerësimin, krahasimin dhe Ekzaminimin e tenderëve nuk e ka bërë konform Nenit 59.4 të LPP-së, me ç'rast nuk ka rrespektuar edhe kërkesën-riterin kryesor e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët sipas Nenit 60 të LPP-së.

Me ç'rast kërkojmë nga Paneli shqyrtues i OSHP-së që pas elaborimit të të gjitha pretendimeve tona ankimore në lidhje me shkeljet e supozuara të dispozitave ligjore që janë në fuqi, të nxjerr:

VENDIM

1. APROVOHET si e bazuar ankesa e G.OE. “SIG Shpk” & “Group for Security Shpk” në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

2. ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**, dhe pas Rivlerësimit të ofertave të shpërblej kompaninë e cila është e vetmja ofertë e përgjegjshme me çmimin më të ulët.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	<p>Kapaciteti teknik dhe profesional:</p> <p>1.Kontratat e realizuara brenda 3 viteve te fundit</p> <p>2.Kualifikimet profesionale dhe edukative të stafit menaxheria</p> <p>3.Pajisjet - Veturat patrulluese</p> <p>4.Certifikatë të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i></p> <p>1. Një listë të kontratave te realizuara nga tenderuesi në 3 vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate.</p> <p>2. Dëshmi që Menaxheri i Projektit posedon a. Diplomë të vlefshme Universitare, b. Përvojë 3 vjeçare në lëmin e sigurimit fizik, c. Licencën për Menaxher nga MPB-me në fushën e sigurisë fizike sipas Ligjit Nr. 04 L-004 për Shërbimet Private të sigurisë. Te dëshmohet me kopje te diplomës, kopjes se licencës dhe kontrate pune apo para kontrate. Dëshmi se zyrtari ngarkuar për siguri dhe shëndet ne pune posedon Certifikatat nga MPMS për dhënien e provimit profesional nga fusha sigurisë dhe shëndetit në punë, sipas ligjit NR. 04 L-161 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË dhe akteve të ndërlidhura nënligjore. Te dëshmohet me kopje te certifikatës, dhe kontrate pune apo para kontrate. Dëshmi qe do te angazhohen jo me pak se 4 Mbikëqyrës (menaxhera) të Zonave. Ata duhet te posedojnë a. Minimum shkollim të mesëm, b. Te jene te certifikuar (licencuar) ne fushën e sigurisë sipas ligjit 04 L-004 dhe c. Se paku 2 vite përvojë në sektorin e shërbimit të sigurimit. Te dëshmohet me kopje te diplomës, kopje te licencës dhe kontrate pune apo para kontrate.</p> <p>3. Dëshmi qe tenderuesi posedon jo me pak se 4</p>
			<p>(katër) vetura patrulluese te terrenit (4x4) . Te dëshmohet me kopje te certifikatave te regjistrimit te automjeteve (lejeve të qarkullimit).</p> <p>4. OE duhet t'i dorëzoj:</p> <p>Kopjet e Certifikatave EN-ISO 9001- 2015, EN-ISO 27001</p>

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

--

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "S.I.G. SH.P.K.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi fizik i objekteve te KEK-ut" me numër të prokurimit: "KEK-23-4552-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KORPORATA ENERJETIKE E KOSOVES sh.a.



Letër standarde për [tenderuesin] e eliminuar ¹

KORPORATA ENERJETIKE E KOSOVËS SH.A.,
Rr.Nëna Terezë, nr.36, 10000 Prishtinë

Grup i Operatorëve Ekonomik S.I.G. SH.P.K.; Group For Security SH.P.K.,
Kosovë, Prishtinë

Nr i prokurimit	KEK-23-4552-2-1-1
Nr i brendshëm	KEKO-23-184-211

Titulli: Sigurimi fizik i objekteve te KEK-ut

Të nderuar,

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këtë arsye:

Keni dëshmitë se posedoni vetëm dy vetura të dokumentuara për shfrytëzim në baze të kërkesës në DT, ndërsa për veturat tjera mungon dokumentacioni që anëtarët e konsorciumit i kanë në shfrytëzim.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.


Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,


Zyra Ekzekutive e Prokurimit

02/08/2023

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "S.I.G. SH.P.K.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi fizik i objekteve te KEK-ut" me numër të prokurimit: "KEK-23-4552-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KORPORATA ENERJETIKE E KOSOVES sh.a.



KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.O.

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES
Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik


Titulli: Sigurimi fizik i objekteve te KEK-ut

Numri i aktivitetit të prokurimit: KEK-23-4552-2-1-1
KEKO-23-184-211

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës
1.	"SAS" SH.P.K. dalip dalipi. 60 000. GJILAN	2627472.00
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik <u>S.I.G.</u> SH.P.K.; Group For Security SH.P.K., Mati I Rr. Muhamet Qame B-4-1, 10000, Prishtinë	<u>2807612.70</u>
3.	Grup i Operatorëve Ekonomik DEFENCE SECURITY SH.P.K.; International Security AAH SH.P.K., PRISHTINË, 10000, PRISHTINË	2746970.14
4.	Grup i Operatorëve Ekonomik Bold Security SH.P.K.; Drita Security Sh.p.k., Rruga Lidhja e Lezhës, nr. 97, 42000, Vushtrri	2617863.51
5.	Rojet E Nderit SH.P.K., Prishtinë, 10 000, Prishtinë	2776119.92
6.	"Internat Security Association" SH.P.K., Mustafë Kruja nr.3, 10000, PRISHTINË	2720579.85
7.	Security Code, MUHARREM FEJZA- BLL,III,HY.IV.LOK.15-1, 10000, PRISHTINË	3005114.50

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:
KORPORATA ENERJETIKE E KOSOVES sh.a. shpërblen me kontrate OE me te lire te përgjegjshëm "Internat Security Association" SH.P.K., ne vlere totale te ofertës 2,720,579.85 Euro me TVSH.

Me respekt,
Zyra Ekzekutive e Prokurimit
KEK – sh.a.


02/08/2023

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - S.I.G. SH.P.K.

Sqarim hyrës:

Aktiviteti i prokurimit me titull " Sigurimi fizik i objekteve te KEK-ut" me nr. të prokurimit: "KEK-23-4552-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a. ka filluar duke publikuar njoftimin për kontratë me datë 19.05.2023, me procedurë të hapur, kontratë publike kornizë me një operator ekonomik, lloji i kontratës Shërbim, kriteri i vlerësimit operatori me çmimin më të ulët, hapja e ofertave është bërë me datë 12.06.2023, njoftimi mbi vendimin e AK-së publikohet me datë 02.08.2023.

OE ankuesi pretendon se AK nuk ka vlerësuar drejtë ofertat, duke shkelë dispozitat ligjore përkatësisht nenet 1, 7, 10, 28, 59, 60, 61, 69, 72, dhe 108/A të LPP-së.

Përgjigje në pretendimin e parë kundër AK-së:

Pretendimi i parë:

Pas pranimit të vendimit të Autoritetit Kontraktues, kemi kërkuar qasje në dokumentacionin e gjithë aktivitetit të prokurimit konform par.3 të Nenit 10 të LPP-së. Autoriteti Kontraktues nuk na ka lejuar qasje të plotë në të gjithë dokumentacionin e aktivitetit të prokurimit, por ka ofruar vetëm qasje të kufizuar duke na treguar në kompjuter vetëm disa pjesë të OE të rekomanduar për kontratë, duke na mohuar të drejtën e qasjes konform dispozitës së Nenit 10 të LPP-së, të njëjtit nuk na kanë ofruar që dokumentet të i pranojmë përmes USB, pasi që janë thirrur në konfidencialitet/sekret afarist, mirëpo Neni 11 i LPP-së përkatësisht par.4 i LPP-së e rregullon këtë çështje ku thuhet se AK një element brenda dokumentit të klasifikuar si sekret afarist duhet të përgatis versionin e "pastruar", gjë që nuk është bërë nga Autoriteti Kontraktues. Andaj ne jemi krejtësisht të diskriminuar dhe nuk jemi trajtuar në mënyrë të barabartë konform Nenit 7 të LPP-së, si për rastin e eliminimit të kompanisë sonë po ashtu edhe në rastin e ofrimit të qasjes në dokumentacionin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Eksperti Shqyrtues lidhur me pretendimin e parë të OE ankues sqaron se, në ofertën e OE të rekomanduar gjendet aneks 3 kërkesa për konfidencialitet, ku AK duhet që të klasifikoj informatat sekrete afariste, të cilat konsideron se mund ta dëmtojnë operatorin ekonomik në ofertë, mirëpo për pjesën tjetër duhet që ti epët qasja, **andaj pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Përgjigje në pretendimin e dytë i OE ankues kundër eliminimit:

Pretendimi i dytë:

Keni dëshmitë se posedoni vetëm dy vetura të dokumentuara për shfrytëzim në bazë të kërkesës në DT, ndërsa për veturat tjera mungon dokumentacioni që anëtarët e konsorciumit i kanë në shfrytëzim.

Provë: Letër standarde për tenderuesin e eliminuar, datë 02.08.2023

Kompania jonë e ka kundërshtuar eliminimin e kompanisë sonë në arsyetimin e cekur, pasi që ne kemi vendosur numër të mjaftueshëm të dokumenteve lidhur me veturat e kërkuara, ne po ashtu kemi bashkangjitur të gjitha marrëveshjet për shfrytëzimin e tyre me qera nga kompanitë bashkëpunuese.

Konzorciumi ynë "SIG Shpk & Group for Security Shpk" në ofertë ka të vendosur gjithsejt 10 vetura, kurse kërkesa e Autoritetit Kontraktues ka qenë të vendosen 4 vetura patrolluese.

- Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet "SIG Shpk" dhe "Jaguar Security Shpk" i datës 09.06.2023 saktësisht në Nenin 3 specifikohet kjo se "Dokumentet e veturave të kompanisë Jaguar Security Shpk të cilat i ka në emër të saj apo kompanive të tjera me të cilat ka marrëveshje Rent a Car Mara dhe Elron Shpk, për të cilat kompania Jaguar Security Shpk ka marrëveshje të lidhura me këto kompani për marrjen e veturave me qera gjithashtu i lejohet se të njejtat vetura të këtyre dy kompanive të lartëcekura do të mund ti përdor për këtë tender, gjë që i lejohet dhe i jepet kjo e drejtë nga ana e kompanisë Jaguar Security Shpk".

Eksperti Shqyrtues sa i përket arsyes së eliminimit të OE ankues sqaron se, në ofertën e OE ankuesit gjenden disa vetura, të cilat kanë marrëveshje me një kompani, e cila po ashtu ka marrëveshje me kompanin tjetër, dhe si e tillë, AK sa i përket dokumenteve ne oferte gjatë procesit të vlerësimit ka mundur të kërkoj sqarime konform nenit 72 të LPP-së, **andaj pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Përgjigje në pretendimin e tretë të OE ankues kundër OE të rekomanduarit:

Pretendimi i tretë:

OE i rekomanduar për kontratë "Internat Security Association Shpk" pretendojmë se nuk është i përgjegjshëm qoftë administrativisht (në dokumentacion) po ashtu edhe financiarisht (sipas analizës financiare). Në kërkesë për rishqyrtim e kemi cekur se i njejtë Analizën financiare të prezantuar e ka të gabuar dhe jo të plotë konform asaj se çfarë është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit/ Aneksin 1 tek specifikimet teknike të detyrueshme.

Gjatë qasjes së kufizuar në dokumentet e po këtij operatori ekonomik kemi hasur se i njejtë nuk e përmbush kërkesën nr.2 pika b), ku zyrtari i ngarkuar për shëndet dhe siguri në punë nuk e ka vendimin valid të ri-certifikimit të MPMS-së. Ne e kemi atakuar këtë pikë gjatë kërkesës për rishqyrtim, kurse Autoriteti Kontraktues ka dhënë një shpjegim formal dhe jo të bazuar konform dokumentacionit të duhur. Provë: Certifikata e ofruar nga ana e OE për personin Shaban Hereqi i cili nuk është i ri certifikuar me vendim nga ana e MPMS.

Po ashtu dyshojmë se dëshmitë e tjera si: dokumentet e 4 menaxherëve të zonave nuk i përmbush ky Operator Ekonomik i rekomanduar për kontratë, pasi që nuk na është lejuar shiqimi i dokumenteve të

këtyre personave që ka angazhuar. I njëjti dyshohet se nuk ka plotësuar kërkesat e tjera konform Nenit 69 të LPP-së, andaj kërkohet që të vërtetohet se i njëjti ka të vendosura dokumentet e kërkuara sipas pikës 1,2,3,4 të Nenit 69 të LPP-së

Eksperti shqyrtues sa i përket pretendimit të OE ankues kundër OE të rekomanduarit sqaron se, lidhur me *kërkesën nr.2 pika b), ku zyrtari i ngarkuar për shëndet dhe siguri në punë nuk e ka vendimin valid të ri-certifikimit të MPMS-së, OE i rekomanduar ka të bashkangjitur certifikatën për dhënie të provimit me datë 12.12.2020, ku pas verifikimit në faqen zyrtare të MPB-se të lista e eksperteve të certifikuar për sigurinë dhe shëndetin në punë, gjendet emri i të njëjtit zyrtar si dhe data e provimit, dhe si e tillë pretendimi nuk gjendet i bazuar, po ashtu sa i përket kërkesës për 4 menaxher të zonës, kemi verifikuar në ofertë dhe janë të licencuar në fushën private të sigurisë nga MPB.*

Përgjigje në pretendimin e katërt të OE ankues kundër OE të rekomanduarit:

Pretendimi i katërt:

Operator ekonomik gjatë kalkulimeve që i ka bërë shihet se nuk janë konform dispozitave ligjore të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, për shkak se llogaritja e cmimit njësi për orë pune nuk është konform Nenit 56 të po këtij ligji pasi që parashihen pagesat shtesë si: orët e punës gjatë natës, gjatë festave, gjatë kujdestarive si dhe gjatë vikendeve, për të cilat ky OE ju është shmangur kalkulimit të saktë, me crast ka arritur të lajthit Autoritetin Kontraktues që të mos arrij që gjatë vlerësimit të bëjë llogaritje të saktë.

Eksperti shqyrtues sqaron se, OE i rekomanduar sa i përket analizës konsideroj se nuk ka futur në kalkulim si psh. shujtën konform DT-se, pra kërkesa e Ak-se ka qenë minimum 2 euro shujte ditore, gjersa OE i rekomanduar ka kalkuluar shujtën me 1.13 euro, dhe si e tillë pretendimi gjendet i bazuar.

Përgjigje në pretendimin e pestë të OE ankues kundër OE Defence Security SHPK:

Pretendimi i pestë:

Tek ky Operator ekonomik gjatë kalkulimeve që i ka bërë shihet se nuk janë konform dispozitave ligjore të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, për shkak se llogaritja e cmimit njësi për orë pune nuk është konform Nenit 56 të po këtij ligji pasi që parashihen pagesat shtesë si: orët e punës gjatë natës, gjatë festave, gjatë kujdestarive si dhe gjatë vikendeve, për të cilat ky OE ju është shmangur kalkulimit të saktë, me crast ka arritur të lajthit Autoritetin Kontraktues që të mos arrij që gjatë vlerësimit të bëjë llogaritje të saktë.

Eksperti shqyrtues sa i përket pretendimit të OE ankues lidhur me analizën e OE Defence Security SHPK sqaron se, OE ankuesi në ankese ka bashkangjitur një dëshmi lidhur me analizën mirëpo tek shujta mendohet se ka ndërhyrje nga 2 euro OE ankues (ju) keni vendosur 1 euro, kurse sa i përket

kalkulimit, në analizë shihet tek pika 4. Per festa 7500 euro, mirëpo AK gjatë procesit të rivlerësimit duhet ta sqaroj analizën edhe njëherë, dhe si e tillë pretendimi gjendet pjesërishtë e bazuar.

PHYSICAL SECURITY

PËR: KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.

NGA: "DEFENCE SECURITY" SHPK

LËNDA: ANALIZË

Të nderuar bazuar në kërkesen tuaj më poshtë gjeni Analizen e detajuar.

Nr	SQARIMI	VLERA	TOTALI
1.	Pagat duke perfshire te gjitha ndrrimet jane	371 x 422.9x 12 muaj	1,882,751.00 €
2.	35 punonjes shtese si zevendesues	35x386x12	162,120.00 €
3.	Pagat e menaxhereve 4+1 Projekt menaxheri	119.20*22*12	31,468.80 €
4.	Per festa eshte parapare nje buxhet prej	12 festa	7,500.00 €
5.	shujta x 2 € x 365	286*2*365	208,780.00 €
6.	Sigurimi shendetsor	406*7*12	34,104.00 €
7.	Fitimi	101.41*12	1,216.88 €
8.	Totali	Totali	2,327,940.68 €
9.	Totali me TVSH	Totali me TVSH	2,746,970.00 €

Sa I përket uniformav dhe paisjeve tjera ne në depo kemi uniforma të mjaftueshme për t'I pajisur të gjithë puntorët e angazhuar në këtë kontratë. Gjithashtu, grupi jonë ka pajisje të mjaftueshme për t'i pajisur te gjitha pikat sipas kerkeses se specifikimit teknik

Kompania jonë është e fokusuar në bashkpunimë afatgjatë dhe rendesi të vacanta janë referencat meqrast në këtë tender kemi paraparë fitim minimal për të mos thënë fare.

DEFENCE SECURITY SH.P.K.

Pagat duke perfshire te gjitga ndrrimet jane	371 x 422.9 x 12 muaj	1,882,751.00
35 punetore shtese si zevendesues	35x386x12	162,120.00
Pagat e menaxhereve 4 1 Projekt menaxheri	119.20*22*12	31,468.80
Per festa eshte parapare nje buxhet prej	12 festa	7,500.00
Shujta x 1 Euro x 365	286*2*365	208,780.00
Sigurimi shendetesor	406*7*12	34,104.00
Fitimi	101.41*12	1,216.88
Totali		
2,327,940.68		
Totali me tvsh		
2,746,970.00		

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**S.I.G. SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Sigurimi fizik i objekteve te KEK-ut**” me numër të prokurimit: “**KEK-23-452-2-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.**

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “S.I.G. SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi fizik i objekteve te KEK-ut” me numër të prokurimit: “KEK-23-452-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **S.I.G. SH.P.K.**

Blerina Huruglica

